



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Kryesia e Kuvendit

P-009

Prishtinë, më 22 mars 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 22 MARS 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit;

Nga Grupet Parlamentare: Adem Grabovci, Ibrahim Makolli, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini dhe Sasha Rashiq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Xheladin Hoxha Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga OSBE-ja: Floriana Shala dhe
NDI: Rinor Beka.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe katër pika shtesë.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 15 mars 2011,
2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 15 mars 2011

Kryesia miratoi pa vërejtje Procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 15 mars 2011.

2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare, më 25 mars 2011

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja e radhës e Kuvendit të mbahet më 25 mars 2011, me këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2011, dhe
3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Komisionin Qendror për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave.

Kryesia, gjithashtu, vendosi që dy pikat e përhershme të rendit të ditës: Deklarimi jashtë rendit të ditës dhe Koha për pyetje parlamentare të mos radhiten në rend dite më 25 mars 2011, me arsyetimin se duhet pasur kohë të mjaftueshme për shqyrtimin e Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2011.

3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave

3.1 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese për zbatimin e masës së përkohshme të nenit 14 paragrafi 1.6 dhe të neneve 22, 24, 25, 27 të Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit

Kryesia, pasi diskutoi lidhur për këtë çështje, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Legjislacion që ta shqyrtojë kërkesën e Gjykatës Kushtetuese, përkatësisht të përgatit përgjigjen e Kuvendit lidhur me kontestimin e nenit 14 paragrafi 1.6, dhe të neneve 22, 24, 25, 27 që kanë të bëjnë me pensionin suplementar të deputetit dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

3.2 Kërkesa e Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Mbeturina lidhur me emërimin e një anëtari të Komisionit Shqyrtues, në cilësinë e kryesuesit të komisionit

Kryesia, pasi diskutoi lidhur për këtë çështje, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor, si komision funksional, që ta shqyrtojë kërkesën e Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Mbeturina lidhur me emërimin e një anëtari të Komisionit Shqyrtues të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Mbeturina, në cilësinë e kryesuesit të komisionit, dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

3.3 Kërkesa e nënkryatrit të Kuvendit, z. Petar Miletqi për pagesën e qirasë së banimit

Kryesia, pasi diskutoi lidhur për këtë çështje, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet kërkesa e nënkryetarit të Kuvendit, z. Petar Miletqi, që t'i bëhet pagesa e qirasë së banimit, në vlerë prej 300 euro në muaj, për gjashtë (6) muaj.

3.4 Raporti vjetor i Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2010

Kryesia, pasi diskutoi lidhur për këtë çështje, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si komision funksional dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa, që ta shqyrtojnë Raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2010, dhe Kuvendit t'ia paraqesin Raportin me rekomandime.

3.5 Raporti i punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për periudhën mars 2009 - dhjetor 2010

Kryesia, pasi diskutoi lidhur për këtë çështje, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si komision funksional dhe Komisionin për Buxhet dhe Financa, që ta shqyrtojnë Raportin e punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për periudhën mars 2009-dhjetor 2010, dhe Kuvendit t'ia paraqesin Raportin me rekomandime.

Pikat shitesë:

1. Propozim-vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Komisionin Qendror të Regjistrimit të Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave

Kryesia, pasi diskutoi lidhur për këtë çështje, vendosi që kjo pikë e rendit të ditës të radhitet për shqyrtim në mbledhjen plenare që do të mbahet më 25 mars 2011.

2. Strategjia Legjislative e Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2011

Kryesia, pasi diskutoi lidhur për këtë çështje, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Strategjia Legjislative për vitin 2011 t'u shpërndahet të gjithë deputetëve të Kuvendit.

2. Ngarkohen komisionet parlamentare që, mbi bazën e Strategjisë Legjislative të Qeverisë për vitin 2011 dhe të propozimeve të veta, t'i hartojnë planet e punës periodike dhe Programin e punës së komisioneve për vitin 2011, deri më 31 mars 2011.

3. Ngarkohet Sekretari i Kuvendit që, mbi bazën e Strategjisë Legjislative të Qeverisë për vitin 2011 dhe të planeve të punës së komisioneve parlamentare, ta hartojë Projekt-programin e punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili, me propozim të Kryesisë së Kuvendit do t'i procedohet mbledhjes plenare, për miratim. Projekt-programi të hartohet deri më 8 prill 2011.

3. Propozim Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e Komisionit qeveritar për privatizimin e PTK-së

Kryesia, pasi diskutoi lidhur për këtë çështje, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri që ta shqyrtojë Propozim - vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e Komisionit qeveritar për privatizimin e PTK-së dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime, për procedim të mëtejshëm.

4. Kërkesa e kryetarit të Komisionit për Integritet Evropian, Lutfi Haziri, për udhëtim zyrtar në Bruksel, më 24 - 27 mars 2011

Kryesia, pasi diskutoi lidhur për këtë çështje, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i kryetarit të Komisionit për Integritet Evropian, Lutfi Haziri, që të jetë pjesë e Delegacionit të Qeverisë së Republikës së Kosovës gjatë vizitës zyrtare që do të realizohet në Bruksel, nga 24 deri më 27 mars 2011.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëimit, të qëndrimit dhe mëditjet përballohen nga buxheti i Kuvendit, sipas vendimit të Kryesisë, nr. 03-V-094.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:05 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.